



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM
Nr.40, datë 28.03.2024

PËR
“MBARIMIN E STATUSIT TË MAGJISTRATIT”

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 64, të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a”, të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për shkak të mbushjes së moshës së pensionit të pleqërisë për zonjën Fahrije Gjana (Vata), me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.
2. Deklarimi i mbarimit të statusit të magjistratit jep efekt më datë 16.03.2024.
3. Të njoftohen për këtë vendim zonja Fahrije Gjana (Vata), Prokurori i Përgjithshëm dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.
5. U shpall në Tiranë, sot më 28.03.2024.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR
Alfred Balla

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Mirela Bogdani

ANËTAR
Olger Eminaj

ZV/KRYETAR
Tartar Bazaj

ANËTAR
Nurihan Seiti

ANËTAR
Moisi Duda

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Vatë Staka